



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

## MEMORANDUM

### NDËRMJET

### KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

### DHE

### FONDIN PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË

bien dakord që të zyrtarizojnë marrëveshjen e bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve, pasi që në rend të parë kjo marrëveshje është në dobi të shoqërisë Kosovare, juristëve, studentëve dhe publikut të gjerë.

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është qasja e FDH Kosovë në komplet dokumentacionin e rasteve gjyqësore duke filluar nga procedura paraprake deri tek vendimet e formës së prerë, që gjykohen pranë gjykatave të Kosovës në të tria shkallët, në gjykimet për veprat penale: krimet e luftës dhe veprave penale me prapavijë politike dhe etnike në bazë të ligjeve në fuqi.

#### Neni 2 Obligimet e Gjykatave të Kosovës

Gjykatat zotohen se do t'i mundësojnë monitoruesve të FDH Kosovë përcjelljen e gjykimeve të lartpërmendura dhe pajisjen e FDH Kosovë me komplet dokumentacionin nga rastet e gjykimeve për krime lufte dhe veprave me prapavijë politike dhe etnike në bazë të ligjit.

#### Neni 3 Obligimet e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovës

FDH Kosovë obligohet që dokumentacionet konfidenciale të pranuar nga këto gjykata të mos i publikon por vetëm ti përdorë për nevojat e tyre të brendshme dhe po ashtu me publikimin e

dokumenteve publike obligohet ti redakton emrat e dëshmitarëve, viktimave dhe të dhënat tjera personale të parashikuara me ligj.

#### **Neni 4 Ndryshimet**

Çfarëdo ndryshimi në përbërje, synime, objektiva, veprimtari apo afate do të marrë miratimin e ndërsjellë të të dyja palëve nënshkruese. Palët do të përpiqen që të gjitha mosmarrëveshjet t'i i zgjidhnin në bazën e mirëkuptimit të përbashkët dhe në partneritet sa i përket objektit të këtij memorandumimi.

#### **Neni 5 Afati**

Palët nënshkruese pajtohen që ky Memorandum i Mirëkuptimit të ketë afat prej 05.09.2019 deri më 06.09.2021 me mundësi vazhdimi, nëse palët për këtë pajtohen paraprakisht.

#### **Neni 6 Zgjidhja e konflikteve**

Në rast të konfliktit në interpretim të këtij memorandumimi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është kompetent për zgjidhjen e konfliktit, respektivisht interpretimin e këtij memorandumimi.

#### **Neni 7 Hyrja në fuqi**

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve nënshkruese dhe vlen deri në momentin e shkëputjes së tij me pajtimin e palëve ose në mënyrë të njëanshme nga cilado palë nënshkruese me paralajmërim prej tridhjetë (30) ditëve.

Me pajtim të plotë, palët nënshkruese, përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, e nënshkruajnë këtë memorandum mirëkuptimi.

Nënshkruar në dy kopje,

Skender Çoçaj

Kryesues  
Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Bekim Blakaj

Drejtor  
FDH Kosovë



Shtator 2019, Prishtinë